

Tabelat e Burim-Përdorimeve 2018

Tiranë, më 29 Shtator 2021: INSTAT publikon tabelat e konsoliduara të Burim-Përdorimeve (TBP), për vitin 2018, të cilat ofrojnë një pamje të detajuar të ekonomisë. Ato janë një instrument i rëndësishëm në analizën dhe krijimin e modeleve statistikore. Këto tabela përshkruajnë; burimet dhe përdorimet e produkteve si dhe lidhjet ndërdegësore në ekonomi.

Burimet dhe Përdorimet gjithsej me çmime korrente në vitin 2018, u vlerësuan 3,554,034 milion lekë, duke shënuar një rritje në terma nominalë, prej 3,8 %, krahasuar me vitin 2017.

Prodhimi përfaqëson 73,4 % të burimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 48,6%, ndërsa shërbimet 51,4 %. Importi përfaqëson 20,8 % të burimeve gjithsej, ku të mirat materiale të importuara përbëjnë 65,9 %, ndërsa shërbimet 34,1 %.

Konsumi ndërmjetës përfaqëson 33,1% të përdorimeve gjithsej me çmime korrente, ku të mirat materiale zënë 70,7 %, ndërsa shërbimet 29,3 %. Kërkesa finale përfaqëson 66,9% të përdorimeve gjithsej, ku kërkesa për të mira materiale zë 59,8 % dhe për shërbime 40,2 %.

Tab. 1: Tabela e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente për vitin 2018, në milion lekë

Aktivitet (NVE)	Të mira materiale	Shërbime	Prodhimi gjithsej sipas produkteve	Importet (CIF)	MTT*	Burime gjithsej	Të mira materiale	Shërbime	Konsumi ndërmjetës sipas produkteve	Kërkesa Finale	Përdorime gjithsej
Produkte (NP)	1	2	3=1+2	4	5	6=3+4+5	7	8	9=7+8	10	11=9+10
Të mira materiale [1-43]	1,260,370	8,074	1,268,444	487,789	497,899	2,254,133	580,880	251,535	832,414	1,421,718	2,254,133
Shërbime [45-98]	56,952	1,283,070	1,340,022	252,606	(292,726)	1,299,902	86,515	257,979	344,494	955,408	1,299,902
Gjithsej	1,317,322	1,291,144	2,608,466	740,395	205,173	3,554,034	667,395	509,514	1,176,908	2,377,126	3,554,034
Vlera e shtuar							649,927	781,630	1,431,558		

* Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

Tabela e Burimeve

Kjo tabelë ofron një vlerësim për burimet e të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara në vend dhe atyre të importuara. Sipas rreshtave paraqiten burimet e produkteve, ndërsa sipas kolonave aktivitetet ekonomike që i prodhojnë këto produkte. Klasifikimi i çdo njësie ekonomike bazohet në produktin që zë pjesën më të madhe të prodhimit të saj.

Për publikim 29/09/2021

Tab. 2: Tabela e Burimeve me çmime bazë dhe transformimi me çmime korrente, në milion lekë

Aktivite (NVE) *	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	Prodhimi sipas produkteve	Importet (CIF)	MTTT**	Burimet gjithsej
Produkte (NP) *	Prodhimi sipas aktiviteve (NVE), me çmime bazë													
A	310,601	-	-	-	-	-	-	-	-	-	310,601	24,631	64,335	399,566
B-E	108,069	439,637	38,993	2,854	17	-	-	3	236	1,529	591,340	463,119	424,165	1,478,623
F	-	10,813	352,257	1,526	-	-	41	1,867	-	-	366,504	39	9,400	375,943
G-I	275	12,388	13,974	452,215	253	-	1,146	6,308	753	460	487,772	121,405	(303,288)	305,888
J	-	400	173	29	112,733	-	-	5	76	122	113,538	21,147	3,866	138,552
K	-	-	-	-	-	61,666	-	-	-	-	61,666	9,405	-	71,071
L	-	-	17,110	2,091	-	-	103,196	1,260	1	38	123,696	-	177	123,873
M-N	-	921	11,073	261	1,304	-	13	195,874	2,808	3,632	215,886	34,539	4,565	254,990
O-Q	-	-	96	21	-	-	10	20	251,585	11	251,743	24,345	223	276,312
R-U	-	537	5	42	7	-	-	28	91	85,011	85,721	41,764	1,731	129,216
Prodhimi sipas aktiviteve	418,945	464,696	433,681	459,039	114,313	61,666	104,406	205,365	255,552	90,803	2,608,466	740,395	205,173	3,554,034


* Grupimi i aktiviteve dhe produkteve bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2) dhe Nomenklaturën e Produkteve (NP 2008)

** Marzhet e tregtisë, transportit dhe taksat neto mbi produktet

Komponentët e tabelës së burimeve për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, shfaqen si më poshtë:


- Prodhimi vendas, i cili përbën peshën kryesore të tabelës së burimeve u rrit me 4,1 %;
- Importet e të mirave materiale dhe shërbimeve pësuan rritje me 2,4 %;
- Taksat neto mbi produktet u rritën me 4,6 %.

Fig. 1: Struktura e Burimeve, në %



Përsa i përket strukturës së tabelës së burimeve sipas origjinës (Fig.2) me çmime bazë, prodhimi vendas zë 77,9 % të burimeve, ndërsa importet zënë 22,1 %. Depërtimi më i madh i të mirave materiale dhe shërbimeve të importuara vërehet tek produktet Industriale me 43,9 %.

Fig. 2: Struktura e Burimeve me çmime bazë, sipas origjinës së produkteve, në %



Në vitin 2018, peshën më të madhe në strukturën e prodhimit me çmime bazë e zënë produktet e Industrisë me 22,7 %, pasuar nga Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor, me 18,7 % dhe Ndërtimi me 14,1 %. Në strukturën e produkteve të importuara, peshën më të madhe e zënë produktet e Industrisë me 62,6 %, ndjekur nga Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor me 16,4 %.

Tab.3: Struktura e Burimeve sipas origjinës së produkteve, 2018

Produktet (NP)	Prodhimi		Importe	
	mln	%	mln	%
A Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	310,601	11,9	24,631	3,3
B-E Industria gjithsej [5-39]	591,340	22,7	463,119	62,6
F Ndërtimi [41-43]	366,504	14,1	39	0,0
G-I Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	487,772	18,7	121,405	16,4
J Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	113,538	4,4	21,147	2,9
K Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	61,666	2,4	9,405	1,3
L Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	123,696	4,7	-	-
M-N Shërbime shkencore, Profesionale, Administrative, Mbështetëse [69-82]	215,886	8,3	34,539	4,7
O-Q Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	251,743	9,7	24,345	3,3
R-U Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	85,721	3,3	41,764	5,6
Burimet gjithsej me çmime bazë	2,608,466	100,0	740,395	100,0

Tabela e Përdorimeve

Në tabelën e përdorimeve paraqiten drejtimet kryesore të përdorimit të burimeve në ekonominë e vendit. Ato paraqiten në formën e përdorimit si: *Konsum Ndërmjetës, Konsum Final i Familjeve, Konsum Final i Administratës Publike, Formimi Bruto i Kapitalit dhe Eksporte*. Kjo tabelë paraqet në kolona strukturën e inputeve për çdo degë të aktivitetit ekonomik dhe në rreshta përdorimin e të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme.

Komponentët e tabelës së Përdorimeve për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 shfaqen si më poshtë:

- Konsumi final, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi u rrit me 5,3 %;
- Konsum Ndërmjetës u rrit me 2,2 %;
- Komponenti i Formimit bruto të kapitalit fiks u rrit me 0,7 %;
- Eksportet e të mirave materiale dhe shërbimeve u rritën me 5,6 %.

Tab.4 : Tabela e Përdorimeve me çmime korrente, në milion lekë

Aktivitete (NVE) Produkte (NP)	A	B-E	F	G-I	J	K	L	M-N	O-Q	R-U	KN* sipas produkteve	SHKF**	FBKF***	Eksport e(FOB)	Përdorime me çmime korrente
	Konsumi ndërmjetës i industrive (NVE)											P3_S13-14	P51-52	P6	
A	81,456	11,797	1,183	8,807	37	5	74	436	334	199	104,328	274,832	4,907	15,499	399,566
B-E	30,741	210,543	194,601	87,190	34,316	2,561	1,380	46,594	36,345	11,093	655,364	566,751	86,090	170,418	1,478,623
F	337	3,848	46,375	5,012	1,596	2	5,865	3,890	4,895	903	72,722	4,885	297,906	431	375,943
G-I	2,718	12,180	4,628	30,321	3,459	1,114	116	10,393	7,221	5,283	77,431	95,672	-	132,785	305,888
J	8	3,601	1,203	3,987	17,096	4,451	267	5,456	6,006	6,285	48,360	61,427	2,428	26,337	138,552
K	312	7,134	4,731	13,121	856	4,069	6,284	1,233	2,339	4,325	44,406	17,533	-	9,132	71,071
L	492	5,996	2,395	6,195	1,834	2,589	105	5,455	820	3,369	29,249	94,624	-	-	123,873
M-N	1,239	7,754	31,211	33,465	8,027	9,030	436	24,594	2,480	10,547	128,784	14,985	14	111,206	254,990
O-Q	-	312	294	549	110	538	2	1,008	2,654	3,988	9,455	256,331	-	10,527	276,312
R-U	0	280	26	1,674	88	58	1	7	4,305	369	6,808	81,994	-	40,414	129,216
KN sipas aktiviteteve	117,304	263,446	286,645	190,320	67,420	24,417	14,531	99,066	67,399	46,360	1,176,908	1,469,033	391,345	516,748	3,554,034
Vlera e Shtuar	301,641	201,251	147,036	268,719	46,893	37,249	89,875	106,300	188,153	44,442	1,431,558				


* Konsumi ndërmjetës

**Konsumi Final i Familjeve dhe Administratës Publike

*** Formimi Bruto i Kapitalit Fiks dhe Ndryshimi i Gjendjeve


Gjatë vitit 2018, struktura e tabelës së përdorimit të të mirave materiale dhe shërbimeve të disponueshme nga përdoruesit brenda dhe jashtë territorit të vendit (Fig.3), paraqitet e tillë: 33,1 % është përdorur për konsum ndërmjetës në proceset e prodhimit; 41,3 % është përdorur për konsum final nga familjet dhe administrata publike; 11% është përdorur për formim bruto të kapitalit dhe 14,5 % është eksportuar.

Fig. 3: Struktura e Tabelës së Përdorimeve, në %



Në tabelën e përdorimeve (Fig.4), të mirat materiale përfaqësojnë 63,4 % të përdorimeve gjithsej, ndërsa shërbimet 36,6 %. Përdorimi i të mirave materiale zë peshën kryesore në formimin bruto të kapitalit me 99,4 % dhe në konsumin ndërmjetës me 70,7%.

Fig. 4: Struktura e Përdorimeve sipas komponentëve, në %



Në vitin 2018, peshën më të madhe në strukturën e përdorimeve të brendëshme me çmime tregu (ku përfshihet konsumi ndërmjetës, konsum final i familjeve dhe administratës publike, formim bruto të kapitalit fiks dhe ndryshim gjendje), e zënë produktet e *Industriës* me 43,1 %, pasuar nga *Bujqësia, pyjet dhe peshkimi* me 12,6 % dhe *Ndërtimi* me 12,4 %.

Në strukturën e produkteve të eksportuara, peshën më të madhe e zënë produktet e *Industriës* me 33,0 %, ndjekur nga *Tregtia, transporti, akomodimi e shërbimi ushqimor* me 25,7 %.

Tab. 6 : Struktura e Përdorimeve sipas destinacionit

Produktet (NP)		Përdorim i brendshëm		Eksport	
		mln	%	mln	%
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi [1-3]	384,067	12,6	15,499	3,0
B-E	Industria gjithsej [5-39]	1,308,205	43,1	170,418	33,0
F	Ndërtimi [41-43]	375,512	12,4	431	0,1
G-I	Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe shërbimit ushqimor [45-56]	173,104	5,7	132,785	25,7
J	Informacioni dhe komunikacioni [58-63]	112,215	3,7	26,337	5,1
K	Shërbime financiare dhe të sigurimit [64-66]	61,938	2,0	9,132	1,8
L	Shërbime të pasurive të paluajtshme [68]	123,873	4,1	-	-
M-N	Shërbime shkencore, Profesionale , Administrative, Mbështetëse [69-82]	143,784	4,7	111,206	21,5
O-Q	Administrata publike, Arsimi, Shëndetësia, Aktivitete të punës sociale [84-88]	265,786	8,8	10,527	2,0
R-U	Arte, Argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi [90-98]	88,802	2,9	40,414	7,8
Përdorimet gjithsej me çmime bazë		3,037,287	100,0	516,748	100,0

Metodologjia

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e TBP-ve mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Ndërtimi i TBP-ve kërkon një numër i madh të dhënash në një nivel shumë të detajuar. Për më tepër lidhur me metodologjinë e përpilimit të TBP, referojuni linkut më poshtë:

<http://www.instat.gov.al/al/publications/librat/2015/tabela-e-burim-p%C3%ABrdorimeve,-2009-2011.aspx>

http://www.instat.gov.al/media/333404/part_d-sut_compilation_albania.pdf

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë: Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE Rev,2); Nomenklatura e produkteve (NP 2008); Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP); Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e TBP-ve përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore etj. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë, e cila është gjithëpërfshirëse, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa të Statistikave të Çmimeve, Statistika të bujqësisë dhe mjedisit, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të administratës publike; Statistika të tregtisë së jashtme; Libri i shitjeve dhe i blerjeve etj.

Procesi i Balancimit

Procesi i balancimit është një proces shumë i rëndësishëm në tabelat e burim – përdorimeve. Pasi është bërë një përpunim i detajuar për secilin komponent duhet që gjithë burimet e një vendi të shkojnë si përdorime nga ana

tjetër, Në shumicën e rasteve, kjo mund të mos arrihet që në hapin e parë të përdorimit të informacionit, për këtë arsye analiza zhvillohet mbi çdo produkt në këtë sistem.

Përpara se të shikohet mospërputhja në nivel produkti, analizohet mospërputhja statistikore që ekziston ndërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit të PBB-së. Në sistemin e tabelave të burim-përdorimeve kjo mospërputhje statistikore eliminohet, si rrjedhim kërkohet që të arrihet ky balancim makroekonomik.

Në rastet kur diferenca ndërmjet burimeve dhe përdorimeve është më e vogël se 5,0 %, përdoret një balancim automatik i mbështetur mbi shpërndarjen në formë raporti të diferencës ekzistuese. Kur kjo diferencë është ndërmjet 5% dhe 10%, mund të mbështetemi mbi një analizë dhe balancim manual të diferencave. Në rastet kur kjo diferencë është më e madhe se 10 %, atëherë jemi në një situatë, e cila kërkon trajtim në burimin bazë të informacionit. Në këto raste mund të jetë e nevojshme që komponentë të ndryshëm të burimeve apo përdorimeve të kërkojnë një rivlerësim, i cili do të sillte një cikël rrethor të vlerësimeve. Ky cikël do të vazhdojë derisa të gjitha diferencat të jenë brenda intervaleve të pranueshme duke na mundësuar një konsistencë të plotë të vlerësimeve të PBB-së me metoda të ndryshme.

Përkufizime

Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korrente: Sistemi i TBP-ve me çmime korrente në Shqipëri është i ndërtuar në nivel produktesh dhe aktiviteteve që korrespondojnë me NVE Rev, 2 dy shifrore. Analizat janë zhvilluar në nivel produkti sipas klasifikimit NP 2008 2, 4 dhe 6 shifrore, duke mundësuar në këtë mënyrë një pamje të qartë të qarkullimit të produktit në ekonomi. Për ndërtimin e TBP-ve në Shqipëri janë kryer një sërë analizash dhe studimesh për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve administrative dhe statistikore. Fokus i veçantë i është vënë kryesisht nivelit të detajimit të të dhënave për të kaluar në një detajim sa më të madh të mundshëm.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte të shërbimeve për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim.

Konsumi ndërmjetës: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësiteve institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB, Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo Fitimprurëse që i Shërbejnë Familjeve (IJFSHs).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHs dhe vlerës së prodhimit tregtar.

Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (fob) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (fob).

Importi i të mirave materiale dhe shërbimeve konsiston në vlerën e transaksioneve në të mira materiale dhe shërbime të rezidentëve me jo-rezidentët.

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

Ndryshimi i gjendjeve: Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit, Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysmë të gatshme, mallra, kafshë, etj.

Marzhi Tregtar përcaktohet si diferencë midis çmimit aktual ose të imputuar të një produkti të blerë për rishitje, dhe çmimit që do të paguhej për zëvendësimin e produktit në momentin e shitjes.

Marzhi i Transportit përfshin koston e transportit të paguar më vete nga blerësi të përfshira në përdorimet me çmime të blerësit, por jo në prodhimin e prodhuesit me çmime bazë apo në marzhin tregtar.

Çmime bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin, Çmimi bazë përfshijë shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime korrente: Çmimet e periudhës referuese, Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat materiale dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.